



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike / Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Data- 13.09.2024

Në bazë të nenit 95 dhe 96 të Ligjit Nr. 08/L - 197 për zyrtarët publikë, si dhe Rregullores (QRK) NR. 05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimit për nëpunësit administrativ dhe mbështetës, Akademia e Kosovës për Siguri Publike shpall konkurs;

Për plotësimin e vendit të punës

Pozita:	Teknik i Mirëmbajtjes - Ngrohtores
Nr. i referencës:	AKSP-162/2024
Numri i vendeve të punës:	1 (një)
Paga bazë (bruto):	I21-koeficienti 3.86
Orari i punës:	I plot
Periudha e kontratës:	Pa afat të caktuar (puna provuese 6 muaj)
Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	
Divizioni për Shërbime të Përbashkëta.	

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës: Mirëmbajtja e të gjitha punëve që kanë të bëjnë me sistemin e ngrohjes.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore;

- Siguron nivel të lartë të funksionimit të sistemit të furnizimit me ujë të ngrohtë dhe sistemin e ngrohjes në ndërtesat e AKSP-së,
- Kryen kontrollet ditore të sistemit të ngrohjes, duke përfshirë riparimet apo ndërrimet e pajisjeve të dëmtuara, si: radiatorët, valvulet, kokat termike, tubat etj,
- Siguron riparimet e vogla dhe të aranzhojë riparimet madhore të kaldajave, rezervuarëve, pompave, qilarëve, njërive për ngrohje të ajrit etj., që shfrytëzohen AKSP,
- Është përgjegjës për mbajtjen në nivel të duhur të presionit të avullit, të nivelit të lëndës djegëse në rezervuar dhe duhet të mbajë shënimet mbi sasi të lëndës djegëse që shpenzohen dhe sasi të aktuale në rezervuar,

- Kontrollon stabilimentet e kaldajave, për shkak të nivelit të sigurisë, që të mos vijë deri te ndonjë avari e mundshme,
- Bënë inspektimin ditor, i cili duhet të jetë i një standardi të lartë profesional, sa i përket funksionimit të të gjitha instalimeve për ngrohje,
- Raporton mbi dëmtimet/ defektet që duhet riparuar dhe përcaktimi i prioriteteve për riparim,
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së shefit të Logjistikës.

Shkollimi, përvoja dhe aftësitë tjera për pozitën

- Diplomë e shkollës së mesme,
- Certifikata /trajnime për pozitën përkatëse,
- Përvoja e punës (përparësi)
- Aftësi profesionale
- Të ketë aftësi të punojë në grup dhe ambiente multietnike.

Kërkesat e përgjithshme për pranimit;

- Të jetë shtetas i republikës së Kosovës,
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji;
- Certifikata se ndaj tij/saj nuk zhvillohen hetime,
- Certifikata e lindjes .

Data e fillimit dhe mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike, duke filluar nga data 30.09.2024 deri me datën 13.10.2024, në ora 16:00.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet duke respektuar legjislacionin në fuqi, nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit dhe intervistës me gojë nga komisioni i pranimit.

Paraqitja e aplikacioneve

Aplikacionet dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike – Vushtrri, zyra e personelit nr.1. Aplikacionit i bashkëngjitet kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurren. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet edhe në web-site, faqja e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike: <http://www.aksp-ks.net/>

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për informata me te hollësishme mund te kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 590 070 Ext 212 ose 213, prej orës 08:00 - 1600.